



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr ____prot

Tiranë më ____ . ____ .2024

VENDIM

Nr. 271, datë 29.05.2024

MBI

**NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË PËRDORIMIT TË FONDEVE NË
SHPENZIME KORRENTE, NË PROGRAMET 01110 DHE KLGJ 03310, PËR
VITIN BUXHETOR 2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitin 2024”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të Ministrit të Financave dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondeve në shpenzime korrente, artikulli 602, nga destinacioni Shërbimi test i penetrimit për përforcimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe infrastrukturën IT, me destinacion Shërbime të tjera në kuadër të masave të sigurisë kibernetike, në shumën 1,400 mijë në programin 01110 dhe në shumën 47,600 mijë në programin KLGJ 03310.
2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe IT, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR